



NEWSLETTER

Prill 2023

Nr.4

Të dhëna për arritjet e radiostacioneve dhe mbi pjesën e shikueshmërisë totale të stacioneve televizive, janar-mars 2023

Për nevojat e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale është përgatitur një hulumtim për arritjet e radiostacioneve dhe për shikueshmërinë totale të stacioneve televizive, për periudhën janar – mars 2023.

Të dhënat për arritjet e radiostacioneve dhe mbi pjesën e shikueshmërisë totale të stacioneve TV janë të disponueshme në [link](#).

Mbikëqyrja e transmetuesve, operatorëve të rrjeteve publike të komunikimit elektronik dhe medias së shkruar

Transmetuesit

Për të konstatuar nëse është vepruar sipas masave vërejtje publike shqiptuar (drejtuar) për mospërbushje të detyrimit për emetim gjatë ditës së paku 30% program të krijuar si vepra audio dhe audiovizuale maqedonase në periudhën nga ora 7:00 deri në ora 19:00, Agjencia ka kryer mbikëqyrje të kontrollit programor ndaj TV Uskana nga Kërçova dhe TV Kaltrina nga Struga. Mbikëqyrja tregoi se TV Kaltrina në programin e emetuar më 11 prill 2023 nuk ka transmetuar së paku 30% të programit të krijuar fillimisht si vepra audiovizuale maqedonase.

Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale ka kryer mbikëqyrje të rregullt administrative mbi 106 transmetues që emetojnë program në televizion dhe radio. Objekt i mbikëqyrjes ishin disa detyrime të transmetuesve: në programet e tyre në terminin primar më së voni deri më 31 mars 2023 të publikojnë të dhënat për strukturën e pronësisë, redaksinë dhe burimet financiare të vitit paraprak, regjistrim nga shpallja t'i dorëzohet Agjencisë në afat prej 15 ditësh nga dita e publikimit, transmetuesit deri në 31 mars 2023, në formular të veçantë të përcaktuar nga Agjencia, të dorëzojnë të dhëna për strukturën e pronësisë, redaktorin përgjegjës/redaktorët, burimet e financimit të vitit paraprak, totalin e të ardhurave dhe shpenzimeve të realizuara nga sigurimi i veprimtarisë dhe për shikueshmërinë mesatare dhe dëgjueshmërinë në vitin paraprak. Mbikëqyrja tregoi se TV Kompani 21-M nga Shkupi dhe TV Iris nga Shtipi nuk i kanë plotësuar në tërësi të gjitha detyrimet.

Pas skadimit të afatit për harmonizim ligjor të masës vërejtje publike, për respektimin e detyrimit për emetim ditor të 30% të programit të krijuar si vepra audio dhe audiovizuale maqedonase në periudhën nga ora 7:00 deri në ora 19:00, mbikëqyrje kontrolli e programit është kryer ndaj TV Dibra. Mbikëqyrja konstatoi se më 21 mars TV Dibra nuk ka emetuar së paku 30% të programit të krijuar burimor si vepra audiovizuale maqedonase, që është në kundërshtim me nenin 92 paragrafi (1) të LSHMAAV.

Operatorët e rrjeteve publike të komunikimit elektronik

Për detyrimin e operatorëve të RRPKE në paketën programore që e ritransmetojnë detyrimisht dhe papagesë për të ofruar shërbimet programore të shërbimit publik radiodifuziv, si dhe për detyrimin për regjistrimin e shërbimit programor në Agjencion dhe titllimin e programeve që i ritransmetojnë, është kryer mbikëqyrje e rregullt programore ndaj operatorëve Kombo 2003, Drim Sat IPTV, Nafi dhe Beko, Neotel dhe Vinsat Kabel. Nga mbikëqyrja nuk u konstatuan shkelje.



NEWSLETTER

Media e shkruar

Ndaj botuesit të medias së shkrua Kolor media plus është kryer mbikëqyrje e jashtëzakonshme administrative për të përcaktuar nëse e ka përmbushur detyrimin për publikimin e të dhënave për emrin dhe adresën e selisë dhe redaksinë e medias së shkruar, të dhëna për personin përgjegjës, redaktorët, shtypshkronjës, datën e botimit ose ribotimit dhe numrin e kopjeve të shtypura, në pajtim (përputhje) me detyrimin nga Ligji për media. Mbikëqyrja rezultoi se botuesi Kolor media plus botuesi i medias „The Economist“ në botimin nr.5 të janarit 2023 nuk ka përmbushur plotësisht detyrimin nga neni 14 paragrafi (1) të Ligjit për media.

Agjencia ka realizuar mbikëqyrje të rregullt administrative ndaj 22 botuesve të medias së shkruar për të konstatuar nëse të dhënat për strukturën e pronësisë i kanë publikura së paku në një gazetë ditore, një herë në vit, jo më vonë se 31 mars 2023 dhe nëse 15 ditë nga dita e publikimit kanë dorëzuar prerje të publikimit tek organi rregullator kompetent. Nga mbikëqyrja u konstatua se mediat e shkruara të përfshira në mbikëqyrje e kanë përmbushur këtë detyrim ligjor.

Masat e shqiptuara vërejtje publike

Këshilli i Agjencisë në seancën e 13-të, mbajtur më 10 prill 2023, miratoi pesë aktvendime për shqiptimin e masës vërejtje publike për Nasha TV, TV Klan Maqedoni, TV Sonce dhe TV Kompani 21-M.

Masë vërejtje publike për Nasha TV është shqiptuar për emetim të serialit pa sinjalin paraprak paralajmërues para fillimit dhe pa shenjën kklasifikuese për kategorinë e programit gjatë gjithë kohëzgjatjes së serialit, për TV Klan Maqedoni për mosrespektim të ndalesës për plasim produktesh në lloje të veçanta të programeve, ndërsa për TV Kompani 21-M për mostransmetim së paku 30% program të prodhuar burimor si vepra audiovizuale maqedonase dhe për mos publikimin e të dhënave për impresium që radiodifuzeri është i obliguar t'i emeton në vendin e duhur për çdo përmbajtje të shërbimit programor.



АГЕНЦИЈА ЗА АУДИО И
АУДИОВИЗУЕЛНИ МЕДИУМСКИ УСЛУГИ



NEWSLETTER

